

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË

EONIA sh.p.k.

Sot, më datë 21.02.2023, ne Tirane, ortakët (me poshtë referuar si "Ortakët Themelues", ose "Ortakët"), si vijon:

Z. Kostandin Jano, i datëlindjes 02.06.1989, lindur në Gjirokastër dhe banues në Tiranë, me nr. personal I90602071K;

Znj. Flonja Boriçi, e datëlindjes 22.07.1972, lindur dhe banuese në Tiranë, me nr. personal H25722043S;

Z. Floran Pustina, i datëlindjes 08.02.1977, lindur dhe banues në Tiranë, me nr. personal H70208073S;

vendosën mbi këtë Akt Themelimi për krijimin dhe themelimin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar EONIA sh.p.k..

I. Themelimi

Ortakët Themelues deklarojnë bashkarisht, themelimin e shoqerise **EONIA sh.p.k.**, një shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar ("Shoqeria"), e cila themelohet në përputhje me ligjin e aplikueshëm tregtar në Republikën e Shqipërisë.

Selia e Shoqërisë është në adresen: Rr. Ismail Qemali, Pasuria 2/827+1-3, Z.K. 8270, Ap. 3, 1019 Tiranë Shqiperi.

Shoqëria është themeluar për një kohëzgjatje të pakufizuar.

II. Objekti

Objekti i aktivitetit te Shoqerisë, do të perfshijë, por nuk kufizohet në aktivitetet e mëposhtme:

- Ngritura, ndërtimi, dhe shfrytëzimi i kapaciteteve gjeneruese dhe prodhuese të energjisë elektrike, gjenerimi, prodhimi, tregimi, furnizimi, ruajtja, dhe shitja e energjisë elektrike, perfshirë por pa u kufizuar në energjinë e rinoleshme, apo të gjitha dhe çdo formë tjetër;
- Të gjitha dhe çdo aktivitet tjetër, dhe ofrimi i të gjitha shërbimeve, dhe shitblerje, në lidhje me të gjitha dhe çdo aktivitet apo industri, të cilat nuk bien ndesh me legjislacionin e aplikueshëm në fuqi.

Ne përputhje me legjislacionin shqiptar për permbushjen e objektit të lartpërmendor, Shoqëria mund:

- (i) të kryejë çdo aktivitet me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme (përfshirë por pa u kufizuar në blerjen, shitjen, e marjen dhe dhënen me qera të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme) si edhe aktivitete tregtare, financiare, qira apo hipotekore të cilat mund të konsiderohen të dobishme apo të nevojshme për përbushjen e objektit të Shoqërisë dhe që nuk tejkalojnë në masë aktivitetet kryesore, të cituara me sipër;
- (ii) të blejë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, interesa në shoqëri të tjera që kanë objekt (objekti i aktiviteti) të ngashëm me atë të Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë saj;
- (iii) të kryejë aktivitete publikimi, marketingu e reklamimi; të kryejë aktivitete të ndërtimit, konstruksionit, projektimit, duke marrë licensat përkatëse;
- (iv) të kryejë aktivitete import - eksporti të mallrave dhe/apo shërbimeve siç do të konsiderohet e nevojshme;
- (v) të kryejë aktivitete për shitjen me pakicë apo shumicë të mallrave, pajisjeve siç do të konsiderohet e përshtatshme, të hapë pikë shitjeje, apo të krijojë një zinxhir pikash shitjeje;
- (vi) të marrë apo të japë franqizë, licensa, marrëveshje administrimi, apo manaxhimi me palë të treta; dhe
- (vii) të kryejë çdo aktivitet tjeter që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm përbushjen e objektit të Shoqërisë.

Shoqëria do të kryejë çdo aktivitet që përfshihet në objektin e saj të aktivitetit dhe/ose që lidhet me objektin e saj.

Shoqëria do të respektojë të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse në Republikën e Shqipërisë dhe standarde më të mira etike.

III. Statuti

Ortakët Themelues deklarojnë pajisjen e Shoqërise me Statutin e Shoqërisë, i cili firmoset dhe ekzekutohet në mënyrë të rregullt nga Ortakët Themelues të Shoqërisë së bashku dhe njëkohësisht me këtë Akt Themelimi.

Statuti i Shoqërisë është dokumenti thelbësor, së bashku me cdo marrëveshje tjeter që mund të firmoset kohë pas kohe nga Ortakët Themelues, që përcakton: emrin, formën ligjore, kohëzgjatjen, objektin e aktivitetit, kapitalin, administratorin, e të drejtat, detyrimet dhe kufizimet e tij, administrimin financier dhe kontabël të shoqërisë, dhe ortakët e Shoqërisë, kompetencat e Asamblesë së Ortakëve, dhe marrëdhënien e Ortakëve mes tyre.

IV. Kapitali

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 1,000.00 Lek, i ndarë në 3 (tre) kuota, dhe ai zotërohet nga nga ortakët e Shoqërisë, si më poshtë vijon:

Z. Kostandin Jano, i datëlindjes 02.06.1989, lindur në Gjirokastër dhe banues në Tiranë, me nr. personal I90602071K, i cili zotëron një kuotë, e cila përfaqëson 80% (tetëdhjetë perqind) të kapitalit te Shoqërisë, dhe është e barabartë në vlerën 800 (tetëqind) lek;

Znj. Flonja Boriçi, e datëlindjes 22.07.1972, lindur dhe banuese në Tiranë, me nr. personal H25722043S, e cila zotëron një kuotë, e cila përfaqëson 10% (dhjetë përqind) të kapitalit te Shoqërisë, dhe është e barabartë në vlerën 100 (njeqind) lek;

Z. Floran Pustina, i datëlindjes 08.02.1977, lindur dhe banues në Tiranë, me nr. personal H70208073S, i cili zotëron një kuotë, e cila përfaqëson 10% (dhjetë perqind) të kapitalit te Shoqërisë, dhe është e barabartë në vlerën 100 (njeqind) lek.

Çështje të tillë si zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë, administrimi financiar dhe kontabël i Shoqërisë, apo çështje të tjera, detajohen në Statutin e Shoqërisë, i cili firmoset dhe ekzekutohet në mënyrë të rregullt nga Ortakët Themelues të Shoqërisë, së bashku me këtë Akt Themelimi.

V. Organet e Shoqerise

Organet e Shoqerise janë:

- 1) Asambleja e Përgjithshme, e cila përbëhet nga Ortakët e Shoqërisë; dhe
- 2) Administratori i Shoqërisë.

VI. Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme, e cila përbëhet nga Ortakët e Shoqërisë, është organi më i lartë vendimmarrës dhe i kontrollit të Shoqërisë e cila merr vendime në lidhje me aktivitetin e saj dhe politikat ekonomike dhe tregtarë të saj.

Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme janë të detajuara në mënyrë të hollësishme në Statutin e Shoqërisë, i cili firmoset dhe ekzekutohet nga Ortakët Themelues të Shoqërisë.

VII. Administratori

Shoqëria përfaqësohet dhe menaxhohet nga 1 (një) Administrator, apo më shumë, i cili është perfaqësuesi ligjor i Shoqërisë dhe e perfaqëson atë, në marrëdhëniet me të tretët dhe është përgjegjës për aktivitetin e zakonshem tregtar të Shoqërisë me perjashtim të atyre çështjeve që parashikohen në Statut dhe nga ligji i zbatueshem apo vendimeve të Ortakëve, apo çdo marrëveshje e ardhshme mes Ortakëve të Shoqërisë.

Administratori i Shoqërisë është:



Z. Kostandin Jano, i datëlindjes 02.06.1989, lindur në Gjirokastër dhe banues në Tiranë, me nr. personal I90602071K ("Administratori").

Administratori emërohet për një afat në detyrë prej 3 (tri) vitesh nga data e regjistrimit të Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ne Shqipëri ("QKB") me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori emërohet nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakëve të Shoqërisë, në përputhje me Statutin e Shoqërisë. Me miratimin e emërimit të tij/saj, Administratori njeh se marrëdhënia e tij/saj me Shoqërinë është një marrëdhënie strikte besimi. Asambleja e Pergjithshme e Ortakëve të Shoqërise ka kompetencë që të shkarkojë Administratorin nga detyra e tij/saj në çdo kohë dhe për çfarëdolloj shkaku.

Të gjitha kompetencat, detyrimet, të drejtat dhe kufizimet e Administratorit të Shoqërisë, si dhe mënyra e përzgjedhjes dhe emërimit, janë të detajuara në mënyrë të hollësishme në Statutin e Shoqërisë, i cili firmoset dhe ekzekutohet nga Ortakët Themelues të Shoqërisë.

Ky Akt Themelimi u hartua ne 5 (pesë) kopje. Akti i Themelimit është hartuar në perputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqërите тregtare", i ndryshuar.


Tiranë, më 21.02.2023

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

Kostandin JANO



Flonja BORIÇI



Floran PUSTINA

